

Pjesë teksti të shkollës “Åkrahäll” lidhur me planin veprues për drogën.

1.NJË CAK I PËRGJITHSHËM

Shkolla”Åkrahäll” do të jetë një shkollë e sigurt dhe pa drogë,që në mënyrë aktive punon që të parandaloj jo shëndetin tek nxënësit.

Në një shkollë pa drogë themi që këtu të mos ketë as narkotikë,mjete stimulative,as mjete tjera narkotike në bazë të receptit mjeksor(jo tjetër përveç atë që urdhërohet prej mjeku),alkool ose lloj droge nuhatëse(thithëse),nuk guxon të jetë e pranishme në shkollë ose në ambientet e shkollës.Ndalimi i duhanit vlenë në të gjithë rrethinën e shkollës.

2.PARANDALESAT NË RAST DYSHIMI PËR KEQPËRDORIM

Sipas ligjit mbi shërbimin social të gjithë ata që punojnë në shkollë me fëmijë dhe të rritur janë të obliguar që sa më parë të lajmërojnë entin për çështje sociale nëse ata në veprimtarinë e tyre kanë njohuri ose dyshime që fëmijët ndjehen keq.Detyra e lajmërimit tek enti për çështje sociale përfundon në ditën e 18/të,mirëpo ekziston mundësia që shkolla të lajmëroj për shqetësim që vlenë për një nxënës 18-19 vjeçar nëse ai përmes sjelljes së tij rrezikon që ta lëndoj vehtë vehten.Shiqoje klauzulën gjenerale në ligjin për çështje sekrete 14:3 nëse kjo është e dukshme që interesimi për të dhënat që zbulohen kanë përparësi parasëgjithash për ato interesa që i mbron ligji mbi çështjen e skretit.

Përgjithësisht vlenë që i gjithë personeli i shkollës do të reagojë shpejtë në situata të dyshimta.Kjo mund të ndodhë nëse ndonjë nxënës mund të jetë i ndikuar nga ndonjë lloj droge në kombinim me mungesa të gjata pranë në shkollë dhe plogështi ose përfolja që bëhet nëse nxënësi është përdorues droge ose posedon drogë.

Nxënësi i dyshuar ose që bën shitje të narkotikës në mënyrë të menjëhershme lajmërohet në polici.Në situata të tilla ndodhë edhe përjashtimi nga shkolla dhe i ndalohet aktiviteti në shkollë për një kohë të caktuar.

Plani veprues hartohet në kordinim në mes shkollës dhe nxënësit.Nëse nxënësi është nën 18 vjeç thirret edhe prindi ose kujdestari në shkollë.

Dallapi i nxënësit nuk është në hapësirën private të nxënësit.Shkolla në disa situata mund të merr vendim që ta hapë dollapin.Kjo vlenë për shembull në rast dyshimi për drogë.

Ne ju mbrojmë juve në raste vijuese të ligjshmërisë.

Këtu poshtë vijon se çka është jo ligjore sipas ligjit që vlenë në lidhje me alkoolin.

- Birra nuk lejohet t’i shiten atë personi që është nën 18 vjeç.
- Të rinjëve nën 18 vjeç nuk ju lejohet t’ju servohen pije alkoolike në një restorant.
- Nuk lejohet që t’ju jepet ose të blihen birra për të rinj nën 18 vjeç.
- Nuk lejohet t’ju jepet dhe t’ju blihet verë,alkohol ose birra me përqindje të lartë alkoholi të rinjëve nën moshën 20 vjeç.

Më poshtë vijon se çka është e denueshme sipas ligjit në fuqi mbi narkotikën dhe ndalesën për disa mjete stimulative.

Disa më të zakonshmet të preparateve narkotike ose të gjetjes së preparateve narkotike si spice,canabis,amfitamin,kat,kokain,heroin,acstacy dhe marihuana.Është e ndaluar që:

- Të posedohet, të përdoret ose në një formë tjetër që të merret me narkotikë.
- Mos jepë narkotikë ose mos furnizo në synim që t'ja japësh dikujt.
- Të përpunohet narkotika.
- Të mos i afrosh dikujt shitje ose të mos jesh ndërmjetës kontakti në mes të shitësve dhe blerësve të narkotikës.
- Të mos e futësh brenda në vend.

Shkolla punon aktivisht që ta parandaloj që nxënësit të mos përfundojnë në keqpërdorim. Nëse prapë se prapë nxënësit përfundojnë në keqpërdorim ne dëshirojmë që nxënësi të merr ndihmë dhe trajtim shëndetësor që të largohet nga kjo. Ne dëshirojmë që nxënësi t'a kryen shkollën dhe që të merr një mbështetje të duhur që të ndjehet mirë.

Översättning av texten på albanska är gjord av Raif Mehmeti, ML-lärare i albanska

-
-
-
-
-